

VENDIM
Nr.570, datë 13.3.2007

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR "TV ROZAFI"

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.044/TVL, të rinovojë, për një afat të ri 5-vjeçar, në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, subjektin televiziv privat vendor "TV Rozafa".
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet e tij që nga data 3.1.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ledi Bianku